

Edicioni i III-të i Debatit Universitar Programi Kombëtar i Debatit Rinor për Modelin e Zhvillimit Social dhe Ekonomik të Shqipërisë

Pedagogët mentorë të universiteteve pjesëmarrëse



Fakulteti i Drejtësisë, Universiteti i Tiranës (FD/UT)

Dr. Petrina Broka

Dr. Petrina Broka, ka kryer studimet pranë Fakultetit të Drejtësisë në vitet akademike 2001-2005, duke u vlerësuar me medalje të artë. Gjatë viteve të studimeve universitare ka punuar pranë organizatave të shoqërisë civile si: Shërbimi Ligjor Falas, Qendra kundër Traumës dhe Torturës, etj. Që prej vitit 2006 është anëtare e Dhomës Kombëtare të Avokatisë. Në vitin 2008, ajo ka përfunduar Studimet e Thelluara Pasuniversitare, pranë Departamentit të së Drejtës Civile, Fakulteti i Drejtësisë, U.T., me rezultate të shkëlqyera. Që nga tetori 2008 e në vazhdim ajo punon si lektore në Fakultetin e Drejtësisë, UT. Në vitin 2013 ajo fiton gradën shkencore “Doktor i shkencave”. Dr. Petrina Broka është autore e një sërë artikujsh shkencorë të botuar brenda dhe jashtë vendit si dhe është pjesëmarrëse në konferenca kombëtare dhe ndërkombëtare. Fushat

kryesore të studimit e kërkimit përfshijnë të drejtën e procedurës civile, zgjidhjen alternative të mosmarrëveshjeve, klinikën e ligjit, të drejtën e konkurrencës dhe zbatimin privat të saj, etj.



Fakulteti i Ekonomisë dhe Agrobiznesit, Universiteti Bujqësor i Tiranës
Prof.Asoc.Dr. Oltjana Zoto

Pedagoge. Departamenti i Ekonomisë dhe Politikave të Zhvillimit Rural

Fakulteti i Ekonomisë dhe Agrobiznesit.

Universiteti Bujqësor i Tiranës

Profesor i Asocuar: Fakulteti i Ekonomisë dhe Agrobiznesit, Universiteti Bujqësor i Tiranës.

Studime të Doktoratës: Doktor i Shkencave në Ekonomiks, Universiteti i Tiranës, Fakulteti i Ekonomik.

Studime Master: MA në Studime Ekonomike Europiane, Universiteti i Tiranës, Fakulteti Ekonomik, Universiteti i Bambergut, Gjermani.

Studimet e larta, Bachelor: BA në Ekonomiks, Universiteti i Tiranës, Fakulteti Ekonomik

Me përvojë të gjatë në mësimdhënie në nivel universitar, eksperience menaxheriale, si menaxhere e Departamentit të Menaxhimit në sektorin publik dhe privat të sistemit universitar.

Ka publikuar artikuj të shumtë shkencor në revista të njohura shkencore brenda dhe jashtë vendit.



Fakulteti i Ekonomisë, Universiteti i Tiranës (FE/UT)

Esmeralda Shehaj

Lektore dhe kërkuese shkencore pranë Fakultetit Ekonomik të Universitetit të Tiranës, që prej vitit 2006. Ajo ka kryer doktoraturën në Universitetin e Staffordshire në Mbretërinë e Bashkuar dhe është lektore e Ekonometrisë, Metodave të Kërkimit në Ekonomiks dhe Shkrimit Akademik. Është përfshirë në shumë projekte kërkimore të financuar nga institucione ndërkombëtare prestigjioze si OSCE, WB, GIZ, RRPP, CERGE-EI, etj. Interesat e saj kërkimore lidhen kryesisht me fushën e emigrimit, varfërisë, ekonomiks in e punës, fuqizimin ekonomik të grave, integrimin e tregjeve, dhe inovacionin në krijimin e vendeve të punës në sektorin publik e atë privat.



Fakulteti i Historisë dhe Filologjisë, Universiteti i Tiranës (FHF/UT)

Dr. Meljana Bregu

Pedagoge në Fakultetin e Historisë dhe Filologjisë në Universitetin e Tiranës

Ka kryer studimet e larta të nivelit BA dhe master në degën e Juridikut të Universitetit të Bolonjës. Pas mbarimit të ciklit 5 vjeçar kreu studimet Master në Shkenca Politike (Politikë dhe Marrëdhënie Ndërkombëtare) në Universitetin e Bolonjës. Në vitin 2016 fitoi gradën “Doktore e Shkencave” në fushën e Marrëdhënieve Ndërkombëtare, Universiteti i Tiranës. Që nga viti 2011 e deri më sot punon si lektore e së Drejtës Ndërkombëtare dhe e së Drejtës së BE, dhe prej vitit 2018 është

koordinatore e modulit Jean Monnet Erasmus + “Shoqëria shqiptare drejt integritit të plotë në familjen evropiane”.



Fakulteti i Shkencave Humane, Universiteti Ismail Qemali, Vlorë (UV)

Dr. Jonida Mehmetaj

Lektore ne Universitet

Eksperiencia e saj profesionale prej më shumë se tetë vjetësh përfshin mësimdhënien si lektore në Universitetin “Ismail Qemali” të Vlorës, koordinatore e studentëve, koordinatore dhe trajnere në organizata të ndryshme jofitimprurëse. Ajo është e angazhuar në mësimdhënien e lëndëve: “Institucionet dhe e Drejta e Bashkimit Evropian”, “Politikat Evropiane të Sigurisë”, “E drejta e Organizatave Ndërkombëtare”, “Filozofia e së Drejtës” etj. Dr. Mehmetaj ka marrë në vitin 2016 gradën shkencore “Doktor” në të Drejtën Ndërkombëtare Publike në Fakultetin e Drejtësisë, Universiteti Europian i Tiranës, studime master “Politika dhe Qeverisja në Evropë” në vitin 2012 pranë Institutit të Studimeve Evropiane, dhe është diplomuar në 2008 për Shkenca Politike në Fakultetin e Shkencave Sociale, Universiteti i Tiranës. Veprimtaria e saj në fushën kërkimore-shkencore është e pasur me pjesëmarrje në konferenca, botime të artikujve shkencorë brenda dhe jashtë vendit si dhe autore e një monografie të titulluar “*Politika e Jashtme dhe e Sigurisë së Përbashkët, Dimensioni juridik dhe politik*” 2018, dhe një cikli leksionesh të titulluar “*Leksione për Filozofinë e së Drejtës*” 2020.



Fakulteti i Shkencave Juridike dhe Politike, Universiteti Aleksandër Moisiu, Durrës (FSHJP/UAMD)

Dr. Elda Zotaj

Lektore dhe kërkuese shkencore

Prej më shumë se 11 vitesh Elda është pedagoge në Departamentin e Shkencave Politike, Universiteti” Aleksandër Moisiu” Durrës ku dhe lektron lëndët si: Integrimin Evropian dhe Organizata Ndërkombëtare. Studimet pasuniversitare dhe doktorale i ka realizuar pranë Institutit të Studimeve Evropiane, Universiteti i Tiranës. Dr.Elda Zotaj ka mbajtur pozicionin e përgjegjës së Departamentit për periudhën 31 maj 2016- 8 shtator 2020. Fusha e kërkimit të saj lidhet ngusht me proceset integruese Evropiane të vendit dhe rajonit. Ajo është autore e më shumë se dhjetëra publikimeve në revista shkencore në konferenca rajonale, kombëtare dhe ndërkombëtare në fushën e Shkencave Politike.



Fakulteti i Shkencave Sociale, Universiteti i Tiranës (FSHS/UT)

Klodiana Beshku (PhD)

Lektore në Universitet

Prej më shumë se 10 vjetësh. Ajo e ka filluar karrierën akademike në Universitetin Aleksandër Moisiu Durrës në vitin 2006, si një prej themeluesve të këtij Universiteti. Që prej vitit 2008 ajo është lektore e parë për lëndët Gjeopolitikë, Teori të Marrëdhënieve Ndërkombëtare e Siguri Rajonale dhe Lëvizje Sociale e Politike pranë Departamentit të Shkencave Politike, Fakultetit të

Shkencave Sociale, Universitetit të Tiranës. Në periudhën 2011-2017 ajo ka qenë kryeredaktore e revistës shkencore “Politikja” të këtij Departamenti, ndërsa në periudhën 2015-2016 Këshilltare pranë Ministrisë së Punëve të Jashtme, nëpërmjet programit LEAD Albania. Ajo mban gradën PhD në Gjeopolitikë nga Universiteti i Pizës, Itali që prej vitit 2011, diplomë në Master në Studime Evropiane të Universitetit të Sienës, Itali dhe Universitetit Robert Schuman III të Strasburgut, Francë dhe Diplomë Magjistrale në Shkenca Politike/Marrëdhënie Ndërkombëtare nga Universiteti i Sienës, Itali. Ajo ka një sërë publikimesh në fushën e gjeopolitikës, politikës së jashtme, studimeve evropiane dhe Ballkanit Perëndimor. Së fundmi, ajo ka qenë kërkuese shkencore pranë Institutit Universitar European të Firences.



Instituti i Studimeve Evropiane, Universiteti i Tiranës (ISE/UT)
Dr. Doris Malaj (Koliqi)

Dr. Doris Malaj (Koliqi) është pedagoge pranë Institutit të Studimeve Evropiane (ISE) në Universitetin e Tiranës prej vitit 2014. Ajo ka kryer studimet Bachelor për Shkenca Politike dhe Drejtësi Publike në Universitetin e Trier-it (Gjermani), studimet Master për Studime Politike dhe Marrëdhënie Ndërkombëtare në Universitetin e Macerata-s (Itali) dhe studimet pasuniversitare (PhD) në Studime Evropiane dhe Integrim European, pranë Universitetit të Tiranës. Ajo është e angazhuar në fushën kërkimore-shkencore ashtu sikurse edhe në mësimdhënie, ku ndër të tjera është lektore për lëndër, *Historia e Diplomacisë, Diplomacia e BE në Marrëdhëniet Ndërkombëtare dhe Politikat e zgjerimit në BE dhe Ballkani Perëndimor.*




Universiteti European i Tiranës (UET)

Klajdi Logu

Pedagog pranë Departamentit të Shkencave Sociale të Aplikuara

Ka përfunduar studimet universitare pranë Fakultetit të Shkencave Sociale në Universitetin e Tiranës, vlerësuar me Medaljen e Eskelencës, për arritje të shkëlqyera akademike. Anëtar dhe bashkëthemelues i Rrjetit të Studentëve Ekselentë pranë Universitetit të Tiranës. Ka kryer studimet pas-universitare dhe veprimtari kërkimore shkencore në Universitetin Eötvös Loránd në Budapest. I angazhuar në mësimdhënie dhe veprimtari kërkimore shkencore pranë Universitetit European të Tiranës, ku po ashtu mbulon rolin e këshilluesit të karrieres dhe editorit të revistës shkencore Polis. Ka publikuar disa artikuj shkencor dhe ka marrë pjesë në disa projektë kërkimore, të fokusuar në çështjet e të drejtave të fëmijëve, barazisë gjinore, mbrojtjes së mjedisit, transparencës së administratës publike dhe angazhimit qytetar. Gjithashtu anëtar i bordit drejtues të Qendrës për të Drejtat në Punë (CLR), e angazhuar në mbrojtjen e të drejtave të punëtorëve. Ka një bashkëpunim dhe angazhim serioz me Qendrën UET dhe World Vision duke shërbyer si trajner i Lidershit gjatë shkollave verore dhe dimërore të zhvilluara nga ky bashkëpunim. Fushat e tij të interesit kërkimor shkencor lidhen me rolin dhe rendësinë e komunikimit, lidershit dhe efektet e teknologjisë dhe konsumerizmit në shoqëri.



Universiteti Fan Noli, Korçë (UNIKO)

Dr. Benita Stavre

Dr. Benita Stavre është e punësuar me kohë të plotë pranë Universitetit “Fan S. Noli”, Korçë. Ka një përvojë pune 21-vjeçare si pedagoge dhe studiuese pranë këtij institucioni.

Pas diplomimit si “Mësues i gjuhës angleze”, në vitin 1999, studimet pasuniversitare (2004-2007) dhe ato doktorale (2009-2013) i kreu pranë Universitetit të Tiranës, në profilin “Shkrimet e autorëve anglezë për Shqipërinë dhe shqiptarët gjatë periudhës së viteve 1921-1939”. Fushat e mësimdhënies dhe ekspertizës kërkimore përfshijnë historinë e qytetërimit dhe atë të gjuhës angleze, si dhe strategjitë e të mësuarit të kësaj të fundit. Ka marrë pjesë si koordinatore institucionale në tre projekte ndërkombëtare Erasmus+ fokusi i të cilave kanë qenë sigurimi i cilësisë në kurrikulat e arsimit të lartë, nxitja e formave të të mësuarit gjatë gjithë jetës për mësuesit në detyrë dhe rritja e kapaciteteve të institucioneve të arsimit të lartë në lidhje me mobilitetet virtuale të studentëve. Që prej vitit 2017, eksperte e jashtme pranë Agjencisë së Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë. Ka shërbyer në pozicione drejtuese si Zv/rektor Universiteti “Fan S. Noli” (2013-2016), Përgjegjës Departamenti i Gjuhëve të huaja, Fakulteti i Edukimit dhe Filologjisë (2016-2020), Zv/rektor për shkencën dhe projektet Universiteti “Fan s. Noli” (aktualisht). Ka botuar mbi tridhjetë punime në fushat e sipërpërmendura në bultetive shkencore kombëtare dhe ndërkombëtare dhe në botimet e mbi njëzet aktiviteteve shkencore ku ka marrë pjesë. Bashkautore e teksteve mësimore “A Practical English Handbook A Study-Guide to Style and Writing” dhe “A Theoretical and Practical Course on English Phonetics and Phonology”, të dy libra dore për studentët e gjuhës angleze.



Universiteti Luigj Gurakuqi, Shkodër (UNISHK)

Dr. Alba Berberi

Lektore pranë Departamentit Administrim-Biznes, Fakulteti Ekonomik, Universiteti “Luigj Gurakuqi”, Shkodër, që nga viti 2008. Fusha kryesore e mësimdhënies dhe kërkimore është menaxhimi, me fokus burimet njerëzore. Kjo evidentohet edhe nga mbrojtja e gradës Doktor i

Shkencave Ekonomike pranë Fakultetit të Ekonomisë, Tiranë, në vitin 2017. Në fokus të dizertacionit është identifikimi i faktorëve që ndikojnë transferimin e praktikave të Menaxhimit të Burimeve Njerëzore - rasti i kompanive të huaja që operojnë në Shqipëri. Gjithashtu, aktiviteti i saj akademik dhe kërkimor zgjerohet më shumë nga pjesëmarrja në konferenca ndërkombëtare; publikime të artikujve në revista kombëtare dhe ndërkombëtare dhe pjesëmarrje në aktivitete të ndryshme shkencore. Gjithashtu, ajo është pjesë e komiteteve organizuese të disa aktiviteteve që organizohen nga Fakulteti Ekonomik dhe trajnuese (për shkrimin e CV-ve dhe përgatitjen për intervistë pune) e studentëve që marrin pjesë në Panairin e Punës, aktivitet i përvitshëm i organizuar nga Fakulteti Ekonomik. Në vitin 2009 përfundon studimet në Laurea Specialistica pranë Universitetit të Firenzës, Itali, duke fituar gradën Master në profilin Qeverisje Korporatash (Corporate Governance). Në vitin 2004, përfundon studimet sipas sistemit 4 vjeçar në degën Financë-Kontabilitet, pranë Fakultetit Ekonomik të Universitetit “Luigj Gurakuqi” të Shkodrës.



Universiteti Marlin Barleti (MB)

Euna Leka

Euna Leka, u diplomua në Marrëdhënie Ndërkombëtare me Summa Cum Laude, në Universitetin La Sapienza, Romë, Itali si edhe master në Menaxhim Konfliktesh dhe Misionë Paqeruajtëse në Universitetin Shtetëror të Torinos në Itali, vlerësuar shkëlqyeshëm. Ajo ka gjithashtu një diplomë të dytë në Gjuhë Shqipe. Është përfshirë në mënyrë aktive në projekte kërkimore si edhe ka një eksperiencë të larmishme në shkrim dhe implementim projektesh të ndryshme kërkimi, edukimi dhe inovacioni në nivel ndërkombëtar dhe kombëtar. Ajo ka një eksperiencë 12 vjeçare në mësimdhënie si pedagoge pranë Universitetit Barleti. Është autore dhe bashkëautore e disa publikimeve në revista shkencore si edhe pjesëmarrëse në konferenca kombëtare e ndërkombëtare, trajnime e workshop-e. Ajo përqendron studimet e saj në fushat e çështjeve ndërkombëtare, të drejtave të njeriut dhe studimeve politike. Znj. Leka ka qenë anëtare e grupit të punës për përpunimin e Strategjisë së Sigurisë Njerëzore dhe është anëtare e rregullt e

Alb-Science dhe Institutit të Sociologjisë.Znj. Leka ka një eksperiencë 5 vjeçare si eksperte në Komisionet e Pranimi në Shërbimin Civil, pranë Departamentit të Administratës Publike. Si edhe ka punuar si Eksperte e Bordit Këshillimor të Periodikut të Diasporës Shqiptare pranë Fondit të Zhvillimit të Diasporës Shqiptare. Për 2 vite ka qenë Drejtoreshë Ekzekutive e Institutit Shqiptar për Çështjet Publike dhe për rreth 3 vite ka shërbyer si konsulente pranë organizatave ndërkombëtare si UNDP, WFP dhe OSBE.



Universiteti Mesdhetar i Shqipërisë (UMSH)

Holta Heba

Specialiste në fushën e komunikimit, marrëdhënie me publikun dhe përkthimit. Me përvojë në mësimdhënie në nivel universitar. Me përvojë në drejtim në nivel universitar. Eksperiencë të pasur pune në menaxhimin e arsimit në nivel universitar. Lektore për lëndët: Elementë komunikimi, Teori komunikimi, Komunikim ndërkulturor. Metoda kërkimi shkencore. Shkrim akademik, Autore e librit: Shqipërimi si art. Rrugëtimi i La Fontenit nga Cajupi te Kokona. MONOGRAFI. Autore e librit: Komunikimi si zgjidhje dhe zgjedhje. Monografi. Autore e librit: Se ti je... Monografi Ka publikuar artikuj shkencorë në revista të njohura shkencore brenda dhe jashtë vendit si edhe ka referuar në konferenca të ndryshme shkencore në fushën e komunikimit dhe përkthimit, brenda dhe jashtë vendit. Ka publikuar artikuj socialë në gazetatat e përditshme brenda vendit.

TRAJNERËT E ZHVILLIMIT TË KAPACITETEVE TË STUDENTËVE



Trajnere për zhvillimin e kapaciteteve të studentëve

Universiteti Luarasi (Luarasi)

Dr.Dorina Gjipali

Gradat dhe Titujt akademikë: Doktore e shkencave (2017).

Eksperiencia e punës: Dr. Dorina Gjipali është aktualisht Përgjegjëse e Departamentit të së Drejtës Publike në Fakultetin e Drejtësisë të Universitetit “Luarasi”. Ajo ka përfunduar studimet “Bachelor” në “Drejtësi” dhe Master i Shkencave në të Drejtën Ndërkombëtare në Fakultetin e Drejtësisë të Universitetit të Bolonjës në Itali. Studimet Doktorale i ka përfunduar pranë Institutit të Studimeve Europiane, Universiteti i Tiranës. Dorina Gjipali ka 10 vjet përvojë në fushën e mësimdhënies si pedagoge e lëndëve “E Drejta Publike”, E Drejta Ndërkombëtare Publike. Aktualisht është lektore në Universitetin “Luarasi” si pedagoge e lëndëve “Teoria e së Drejtës” e “Metoda e Kërkimit Shkencor”, anëtare e Njesisë së Sigurimit të Cilësisë si dhe anëtare e Senatit Akademik të Universitetit “Luarasi”.



Trajner për zhvillimin e kapaciteteve të studentëve

Fabjan Lashi

Konsulent me përvojë në zhvillimin dhe menaxhimin e projekteve TIK. Shkrues, monitorues dhe vlerësues për një sërë projektsh në sektorët e qeverisjes vendore të TIK, arsimit të lartë, menaxhimit të kërkimit dhe zhvillimit, sektorit të bujqësisë TIK, Dokumentacionit të Bankës Gjenetike (GBD), turizmit dhe sistemeve të informacionit të gjurmueshmërisë së sigurisë ushqimore. Ligjërues me përvojë të gjerë në trajnimin e TIK. Ekspert i pasionuar për përpunimin e të dhënave, analizat e të dhënave dhe vizualizimin e të dhënave. Përvojë pune në industri të ndryshme që nga viti 2002, SME BE/KE dhe institucione qeveritare, me fokus të veçantë në projektet që lidhen me teknologjitë e informacionit, zhvillimin e sistemit dhe projektet e inovacionit.



Trajnere për zhvillimin e kapaciteteve të studentëve

Prof. Asoc. Dr. Nevila Xhindi

Znj. Xhindi për më shumë se 25 vjet ka punuar si lektore në disa universitete brenda dhe jashtë vendit si dhe zyrtare në administratwn qendrore dhe lokale. Aktualisht është pedagoge në Universitetin Mesdhetar të Shqipërisë. Fusha e saj e hulumtimit janë zhvillimet rajonale krahasuese me fokus integrimin Europian Ajo ka botuar një numër artikujsh në revista akademike, ka hartuar dokumente të politikave dhe ka realizuar studime të aplikuara në fushën e Integritit europian., si dhe ka qenë drejtuese e Katedrës për Studime Europiane “Jean Monnet“(Jean Monnet Chair 2012-2015), akredituar nga BE. Prej vitesh është e angazhuar në leksione dhe trainime për çështjet e integritit Europian të Shqipërisë në BE.



Mentore e Fushatës “Nga Fjala Tek Veprimi”

Orkidea Xhaferraj

Orkidea është një advokuese njohurish me përvojë të gjerë në sektorin publik dhe privat. Ajo ka një diplomë Master Ekzekutiv në Administratën Publike nga Hertie School of Governance në Berlin, Gjermani, me një bursë nga Fondacioni Shqiptaro-Amerikan për Zhvillim, si edhe një MSc në Informatikë Biznesi nga Fakulteti i Ekonomisë, Universiteti i Tiranës, në Tiranë, Shqipëri. Orkidea ka një interes të thellë për politikat publike dhe inovacionin për zhvillim, me fokus në përdorimin/mbështetjen e bërjes së politikave të bazuara në dëshmi; dixhitalizimi për të forcuar qeveritë dhe komunitetet; komunikimi; Menaxhimi i njohurive; dhe menaxhim projekti. Ajo ka mbajtur një sërë pozicionesh të ndryshme në fushën e politikave publike, zhvillimit ndërkombëtar, komunikimit dhe zhvillimit të përmbajtjes, si dhe ngritjes së kapaciteteve në arsimin e lartë.



Mentore e Fushatës “Nga Fjala Tek Veprimi”

PhD. Erida Curraj

Erida Curraj është një njohëse e mirë e dinamikës së sektorit të biznesit me përvojë profesionale të fituar me më shumë se 12 vite në nivel kombëtar, rajonal dhe ndërkombëtar, kryesisht në Evropë dhe Kinë, duke punuar me aktorë të ndryshëm, nga përfaqësues të biznesit deri te menaxherë të arsimit të lartë dhe akademikë. Ajo ka një punë të shkëlqyer me projektet e Komisionit Evropian dhe të Ballkanit Perëndimor që fokusohen kryesisht te arsimit dhe rinia. Ajo ka një Diplomë Doktorature në Dizajn Industrial, një Program i Përbashkët PhD midis Ferrarës dhe Universitetit Polis. Ajo jep kursin e Dizajnit në Universitetin Politeknik të Tiranës.

SCiDEV TEAM



Drejtoreshë Ekzekutive SCiDEV

Blerjana Bino

Blerjana është eksperte në hartimin, zhvillimin, monitorimin dhe vlerësimin e projekteve. Ajo ka më shumë se 7 vjet përvojë profesionale në kërkim dhe zhvillim në Shqipëri dhe Ballkanin Perëndimor. Ajo ka përfunduar studimet e doktoraturës në Studimet e Medias dhe Komunikimit me një bursë kërkimore në Universitetin Uppsala si anëtare e Institutit Suedez. Ajo ka një Master të Shkencave në Politikë dhe Komunikim nga Shkolla e Ekonomisë dhe Shkencave Politike në Londër në MB. Ajo ka përfunduar një bursë kërkimore në Institutin e Kërkimeve të Komunikimit dhe Medias (CAMRI) në Universitetin e Westminsterit nën një Çmim Studiuës të Shoqërisë Civile (2015) dsi edhe ka fituar një qëndrim kërkimor në Departamentin e Shkencave Politike dhe Sociologjisë, Universiteti i Salzburgut si anëtare e Sigma Agile. (2014). Ajo ka qenë e përfshirë në zhvillimin dhe menaxhimin e projekteve të ndryshme kërkimore dhe ngritjes së kapaciteteve të financuara nga Bashkimi Evropian dhe donatorë të tjerë. Ajo ishte pjesë e Programit Ndërkombëtar të Udhëheqjes së Vizitorëve në SHBA në 2016 dhe është bashkëthemeluese e COORP.



Koordinatorë e komunikimit dhe promovimit të aktiviteteve SCiDEV

Lutjona Lula

Lutjona aktualisht është një studiuese e pavarur dhe zyrtare e komunikimit zhvillimor në një projekt punësimi për të rinjtë. Para kësaj ajo ka shërbyer si Përgjegjëse e Njesisë për Marrëdhëniet Ndërkombëtare dhe Projektet në Universitetin Europian të Tiranës dhe studiuese e asociuar në

Qendrën UET. Ajo është angazhuar në mënyrë aktive në kërkime/konsultime me disa organe si Prezenca e OSBE-së në Shqipëri si studiues i ri, Westminster Foundation for Democracy, ESAA Bruksel si trajner për Menaxhimin e Palëve të Interesit, projekti INFORM Horizon 2020 si studiues i ri. Lutjona Lula, M.A. ndoqi studimet e saj pasuniversitare në Masterin e Përbashkët Ndërdisciplinor në Studime të Evropës Juglindore, në Universitetin e Beogradit dhe në Universitetin Karl Franzens të Gracit. Ajo ka një diplomë bachelor në shkencat politike nga Universiteti i Tiranës. Në vitin 2012 ajo është shpërblyer me Bursë Kërkimore në Universitetin e Gjeorgjisë Jugore, SHBA. Në lidhje me angazhimin në Evropën Juglindore, ajo ka qenë e përfshirë në mënyrë aktive në Procesin e Berlinit të Ballkanit Perëndimor, Forumet Rinore dhe BE-në ngjarje të lidhura me integrimin.



Trajnere dhe Moderatore SCiDEV

Megi Ruka

Megi Ruka, ndoqi studimet master në Universitetin e Salzburgut, Departamenti i Shkencave Politike, me fokus në Shkenca Politike, Integrim dhe Qeverisje në Ballkan. Ajo ka diplomuar në Marrëdhënie Ndërkombëtare nga Universiteti Europian i Tiranës. Ajo është një ish-shefe e kabinetit të Universitetit Europian të Tiranës, ku ka koordinuar nismat strategjike të biznesit, ka mbikëqyrur operacionet e përditshme dhe ka ndihmuar në mbikëqyrjen e projekteve dhe planeve të komunikimit. Ajo ka qenë e angazhuar si Koordinatore Projekti për Institutin Europian Pashko, një OJQ e lidhur me Universitetin Europian të Tiranës, ku ka qenë përgjegjëse për Programin Youth Activism+, koordinimin e disa projekteve të financuara nga donatorë vendas dhe programet Erasmus+. Gjatë qëndrimit në Salzburg, ajo u angazhua si Konsulente për Marrëdhëniet me Publikun në Departamentin e Shkencave Politike, Universiteti i Salzburgut, duke mbështetur departamentin me menaxhimin e përbashkët të projekteve dhe organizimin e takimeve me

përfaqësues të nivelit të lartë të Komisionit Evropian. Në të njëjtën kohë, ajo punoi si studiuese për Institutin e Rajoneve të Evropës, një organizatë joqeveritare me seli në Salzburg.



Trajner dhe Moderator SCiDEV

Adajani ka jetuar dhe studiuar në Kanada dhe gjatë studimeve është angazhuar në skuadrën e debatit të universitetit për tre vite rradhazi si debatues dhe gjyqtar. Ai ka marrë pjesë në disa debate kombëtare Kanadeze dhe ndërkombëtare në Amerikë të organizuara përkatesisht nga Shoqata Universitare Kanadeze për Debatin Ndërkolegjial (CUSID) dhe Shoqata Amerikane e Debatit Parlamentar (APDA). Përtej rolit të tij si debatues dhe gjyqtar Adajani ka qenë edhe trajnues i debatuesve të rinj që i bashkëngjiteshin klubit të debatit në universitet. Me kthimin e tij në Shqipëri prej dy vitesh Adajani punon si analist në Intesa Sanpaolo Bank Albania, me një përvojë paraprake gjashtë vjeçare në disa role të ndryshme në sistemin financiar në Kanada. Kjo përvojë e larmishme e ka mundësuar atë të ketë një prespektivë të shumëanshme mbi sistemin financiar dhe politik të dy vendeve, tepër të ndryshme. Adajani merr pjesë për herë të dytë në edicionin e debatit universitar ku vazhdon të jetë moderator dhe trajnues për studentet pjesëmarrës. Ai rikthehet me shumë dëshirë për të ndihmuar dhe dëgjuar një brez tjetër premtues studenteësh, pjesëmarrës në këtë edicion.



Asistente Projekti SCiDEV

Marime Gjoka

MSc.M.Gjoka është një studiuese e re dhe aktiviste për fushat mjedisore dhe mbrojtjen e trashëgimisë kulturore. Është diplomuar për Arkeologji dhe Trashëgimi Kulturorë studime



Bachelor në Fakultetin e Historisë dhe Filologjisë në Universitetin e Tiranës me rezultate të shkëlqyera. Ajo gjithashtu është diplomuar në Masterin Shkencor në Marrëdhënie Ndërkombëtare me të njëjtat rezultate. Ka realizuar shumë punë vullnetare në gjermim dhe restaurim si edhe është pjesëmarrëse e një sërë trajnimeve dhe konferencave lidhur me rininë. Ish studente debatuese dhe pjesëmarrëse e Fushtatës nga Fjala tek Veprimi. Mënyerë punon si asistente projekti në kuadër të Debatit Universitar në SCiDEV. Merr pjesë në punë vullnetare me që lidhen me rininë dhe kulturën.